# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6917
E premte, 9 qershor 2023
Çmimi 0.40


## Opozita në Prishtinë merr nën menaxhim dhjetë ndërmarrjet publike komunale

FAQE 6




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË, EDI RAMA, PËRPIQET TË JAPË KONTRIBUT PËR ASOCIACIONIN, UA DORËZON NJË DRAFT-DOKUMENT FRANCËS DHE GJERMANISË FAQE 3

# RAMA PROPOZON DRAFT PËR ASOCIACIONIN: S'MUND TA SHOH KOSOVËN TË TKURRET SI SHTET



Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka bërë me dije se këtë draft-dokument për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë ua ka përcjellë presidentit të Francës, Emmanuel Macron dhe kancelarit gjerman Olaf Scholz. Rama ka theksuar se ky dokument është konfidencial, por u shpreh i bindur se është "një dokument i nivelit më të lartë ndërkombëtar që merr në konsideratë të gjitha arsyet për krijimin e Asociacionit dhe që Asociacioni është pjesë e organizimit të jetës për Kosovën". Ai ka treguar se ky draft është punuar nga ekspertët e lartë amerikanë dhe evropianë prej kohësh

## KUVENDI MIRATON PROJEKTLIGJIN PËR ZGJEDHJET PËRGJITHSHME

FAQE 3



## MURATI: AMBASADORËT DHE EMISARËT SPECIALË DIPLOMATIKË PËRÇOJNË QËNDRIMET ZYRTARE TË UASHINGTONIT

FAQE 3



## AKTUALE



### NATO-JA U KËRKON ALEATËVE T'I RRITIN BUXHETET PËR USHTRITË E TYRE F. 2

### MUSLIU: KOSOVA PO E PËRJETON EKSODIN MË TË MADH TË HISTORISË SË SAJ SI PASOJË E KEQQEVERISJES F. 7

### KURTI PRANON TABELËN E NJË RRUGE NË NJU-JORK QË MORI EMRIN E ISMAIL QEMALIT F. 7

## EKONOMI



### ODA EKONOMIKE AMERIKANE PARALAJMËRON KOSOVËN: TENSIONET PENGOJNË INVESTIMET F. 8

### KOMISIONI I AKSIONARËVE TË NPB-S VENDOS PËR "PROJEKTIN NË LAKRISHTË" F. 8

## SPORT



### KURTI: MAJLINDA, SIMBOL I SUKSESIT NË KOSOVË DHE KAMPIONE E PËRJETSHME F. 12


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755 Fax: +389 44 487 200 Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# NATO-ja u kërkon aleatëve t'i rritin buxhetet për ushtritë e tyre

**Bruksel, 8 qershor** - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, dhe ambasadorja e ShBA-së në NATO, Julianne Smith, thanë më 7 qershor se financimi i aleancës ushtarake do të jetë një nga temat kryesore të samitit të ardhshëm në Vilnius së bashku me zgjerimin e aleancës dhe garancitë për siguri.

Smith dhe Stoltenberg, që morën pjesë në një konferencë virtuale të sponsorizuar nga Qendra për Sigurinë e Re Amerikane, thanë se anëtarët do të diskutojnë për pragun për shpenzimin e të paktën 2 për qind të brutoprodhimit të brendshëm të vendeve anëtare të NATO-s në mbrojtje.

Smith u zotua se ShBA-ja do të vazhdojë të bëjë presion për t'u siguruar që anëtarët të shpenzojnë të paktën 2 për qind të brutoprodhimit të brendshëm të tyre në mbrojtje, siç është rënë dakord në Premtimin e Investimeve të Mbrojtjes (DIP) të vitit 2014, i cili kërkon që vendet ta përmbushin pragun prej 2-përqindësh deri në vitin 2024.



Përveç kësaj, Smith tha se 2-përqindëshi "është një prag, jo një tavan" dhe se planet e ardhshme të NATO-s mund të kërkojnë rritje të mëtejshme të këtij pragu.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës "po planifikojnë të sjellin një DIP 2.0" në samit, tha Smith, duke i shtyrë aleatët e NATO-s ta përmbushin dhe kapërcejnë pragun prej 2-përqindësh brenda viteve të ardhshme.

Udhëheqësit e 31 vendeve të NATO-s, të cilët do të mblidhen më 11 dhe 12 korrik në kryeqytetin lituanez, pritet të zhvillojnë biseda kritike për të ardhmen e NATO-s lidhur me një zgjerim të mundshëm.

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, i cili i ka bërë presion NATO-s për ta lejuar anëtarësimin e vendit të tij, pritet të marrë pjesë në samit. Ai tha në fillim të kësaj jave se Ukraina është "gati për t'u anëtarësuar" dhe se aleanca duhet ta marrë një vendim për anëtarësimin e Ukrainës në këtë samit.

Lidhur me zgjerimin e mundshëm të NATO-s, Smith dhe Stoltenbergu bënë të qartë se ekziston një gamë e gjerë modelesh potenciale për kontributin e vazhdueshëm të NATO-s në Ukrainë, por se zgjidhja ka të ngjarë të jetë një kompromis midis opinioneve të ndryshme të aleatëve të NATO-s.

# Britania vendos sanksione të reja ndaj Bjellorusisë



**Londër, 8 qershor** - Britania njoftoi për vendosjen e sanksioneve të reja ndaj Bjellorusisë për shkak të rolit të Minskut në ndihmën që i jep pushtimin rus të Ukrainës. Në sanksione përfshihen edhe ndalesa të importeve dhe masa të reja që synojnë ta parandalojnë propagandën në internet.

Bjellorusia, që udhëhiqet nga Alyaksandr Lukashenka që nga viti 1994, është aleatja më e palëkundur e Rusisë në mesin e ish-shteteve sovjetike dhe lejoi që të përdorej territori i saj që Kremlini ta niste pushtimin e Ukrainës në shkurt të vitit 2022.

Muajin e kaluar Rusia vendosi që t'i dislokonte armët bërthamore taktike në territorin bjellorus.

"Kjo paketë e re e sanksioneve rrit presionin ekonomik ndaj Lukashenkës dhe regjimit të tij, i cili në mënyrë aktive mbështet përpjekjet e luftës së Rusisë dhe injoron integritetin territorial të Ukrainës", tha përmes një deklarate sekretari britanik i Jashtëm, James Cleverly.

Paketa e re e sanksioneve përfshin ndalesën për importet e arit, cementit, drurit dhe plastikës nga Rusia dhe, po ashtu, ndalon eksportet nga Britania për në Bjellorusi të parave të gatshme dhe makinerive, por edhe të mallrave të tjera, teknologjisë dhe materialeve që mund të përdoren për të prodhuar armë kimike dhe biologjike.

Britania tha, po ashtu, se do të jetë e aftë t'i parandalojë kompanitë mediale bjelloruse nga "shpërndarja e propagandës në Mbretërinë e Bashkuar" përmes kompanive të rrjeteve sociale dhe ofruesve të shërbimeve të internetit duke ua kufizuar qasjen në internet.

Qeveria britanike, po ashtu, njoftoi se do të ndërmarrë hapa për t'i ndëshkuar subjektet që tentojnë t'i shmangin sanksionet, përfshirë edhe përmes kufizimit të fondeve për Bjellorusinë, por edhe kufizimeve të tjera.

# Izraeli kryen bastisje në Ramallah, dhjetëra të plagosur gjatë përleshjeve

**Ramallah, 8 qershor** - Dhjetëra persona janë plagosur në qytetin Ramallah, në Bregun e pushtuar Perëndimor, pasi forcat izraelite kryen një bastisje. Ushtria izraelite tha se operacioni kishte për qëllim rrëzimin e një shtëpie të një palestinezi që akuzohet për sulm me bombë vitin e kaluar.

Ministria palestineze e Shëndetësisë tha se të paktën 35 persona janë plagosur, përfshirë të paktën 20 persona të plagosur me armë zjarri. Sipas kësaj ministrie, dy persona kanë pësuar lëndime të rënda, ndërkaq një tjetër është plagosur në kokë me plumb gome. Sipas "Reuters"-it, një autokolonë e madhe ushtarake hyri në qendër të Ramallahut, ku gjendet qeveria palestineze në Bregun e pushtuar Perëndimor, dhe më pas qindra palestinezë u mblodhën në atë zonë.

Disa palestinezë të rinj hodhën gurë drejt ushtarëve izraelitë, të cilët u përgjigjën ndaj turmës me të shtëna me armë zjarri, shok-bomba dhe granata dore, sipas "Reuters"-it.



Ushtria izraelite tha se ushtarët u konfrontuan me turmën të cilët hodhën në drejtim të tyre koktej molotovi dhe gurë, dhe si kundërpërgjigje ushtarët nisën të shtinin drejt tyre. Një gazetar palestinez është lënduar pasi është goditur nga një plumb gome dhe ky incident është duke u hetuar nga autoritetet.

Ushtria izraelite tha se forcat e saj kryen një operacion për ta rrënuar shtëpinë e Islam Faroukh, i cili u arrestua vitin e kaluar nën dyshimet se ka kryer një sulm vdekjeprurës me bombë në Jerusalem.

Sulmi që ndodhi nëntorin e kaluar la të vrarë dy persona, përfshirë një adoleshent izraelito-kanadez, si dhe u plagosën 14 të tjerë. Autoritetet thanë atëbotë se sulmuesi kishte vendosur bomba artizanale në disa stacione autobusi dhe i kishte aktivizuar njëkohësisht.

Izraeli në mënyrë rutinore shkatërron shtëpitë e personave që dyshohet se kanë kryer sulm, por kritikët e kanë dënuar këtë praktikë, që është joligjore sipas ligjit ndërkombëtar humanitar.

Dhuna në Bregun Perëndimor, përgjatë territoreve ku palestinezët kërkojnë ta krijojnë shtetin e tyre, është rritur që nga viti i kaluar. Izraeli ka shtuar bastisjet ushtarake pas sulmeve vdekjeprurëse që janë kryer në qytete të ndryshme nga palestinezët.

Ministria palestineze e Shëndetësisë ka thënë se të paktën 158 palestinezë janë vrarë nga forcat izraelite që nga janari. Ministria e Jashtme e Izraelit ka thënë se 20 izraelitë dhe dy shtetas të huaj janë vrarë gjatë sulmeve palestineze në po të njëjtën periudhë.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Kuvendi miraton Projektligjin për Zgjedhjet Përgjithshme



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

Prishtinë, 8 qershor - Deputetët e Kuvendit kanë miratuar në parim Projektligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Për kanë votuar 86 deputetë, asnjë kundër dhe një abstenim.

Të gjitha partitë politike janë pajtuar që Projektligji për Reformën Zgjedhore duhet të kalojë në seancën e së enjtes. Shoqëria civile e ka kundërshtuar këtë projektligj, duke thënë se "përmban ndryshime të cilat cenojnë integritetin zgjedhor".

Kryeministri Albin Kurti në fjalën e tij në seancën plenare të Kuvendit mbi Projektligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme ka thënë se përpjekjet për reformë zgjedhore patën filluar menjëherë pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2010, të cilat u patën karakterizuar me parregullsi dhe manipulime të shumta saqë u cilësuan nga misione të ndryshme vëzhguese ndërkombëtare si "vjedhje industriale e votave". "Kjo tentativë për reformë zgjedhore nuk arriti të rrumbullakohej për shkak të mungesës së vullnetit politik të asaj kohe dhe zhvillimeve të tjera politike", ka thënë Kurti.

Kurti ka thënë se ndër çështjet më të rëndësishme të cilat rregullohen me këtë projektligj janë: regjistrimi i votuesve jashtë vendit, mënyra e votimit jashtë vendit, e drejta e votës, numërimi votave/fletëvotimeve për kandidatët e subjekteve politike dhe mbështetja financiare shtesë për parti të cilat krijojnë hapësirë për numër më të madh të deputeteve gra sa është kuota e përcaktuar. "Projektligji i ri e parasheh regjistrimin online përmes një platforme që do ta krijojë KQZ-ja në mënyrë që votuesit nga mërgata të mos kenë nevojë të dërgojnë dokumente të shumta qoftë përmes email-it ose përmes Postës. Me platformën e regjistrimit online synohet të zvogëlohen barrierat teknike dhe procedurale, por edhe të ulet kostoja e të rritet efikasiteti. Me projektligjin e ri mërgata do t'i ketë tri mënyra të votimit. E para, votimi fizikisht në ambasada dhe konsullata; e dyta, votimi duke i dërguar me postë të brendshme në adresë të ambasadës; e treta mbetet mënyra e vjetër duke i dërguar ato në adresë të KQZ-së", ka thënë Kurti.

Ai ka shtuar se me ligjin e ri e drejta e votës u takon vetëm atyre që janë të regjistruar në regjistrin civil, respektivisht ata që janë pajisur me dokumente të Republikës së Kosovës. "Me këtë projektligj ruhet shpejtësia e numërimit të votave për parti politike si dhe shpallja e rezultateve disa orë pas mbylljes së vendvotimeve. Por, projektligji, gjithashtu, adreson shkakun kryesor të rinumërimeve, duke bartur numërimin e votave për kandidatët në qendrat komunale të numërimeve, përmes një procesi transparent gjë që mundëson certifikim më të shpejtë të rezultateve zgjedhore. Me projektligjin e ri KQZ-ja ndan fonde publike shtesë në vlerën 1 % të shumës së përgjithshme të alokuar për subjektin politik për secilin mandat të fituar nga gratë mbi kuotën 30 % në momentin e certifikimit", ka deklaruar Kurti.

Kryeministri ka thënë se Ligji i ri për Zgjedhjet do t'i japë fund padrejtësisë së gjatë që u është bërë të gjithë mërgimtarëve, shtetasve të Kosovës. "Lidhja e tyre e fuqishme me vendin e vet, kontributi i tyre i pamohueshëm në çdo kohë e në çdo rrethanë, e bën edhe më të domosdoshme nevojën që ata të jenë sa më shumë pjesë aktive e vendimmarrjes në atdheun e tyre", është shprehur Kurti.

Në emër të grupit punues për reformën e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, Abelard Tahiri ka thënë se nga 130 nene gjithsej, 92 janë rishkruar apo rihartuar tërësisht. "Në Projektligjin për Zgjedhjet Nacionale, prej 130 neneve gjithsej, 92 janë rihartuar apo shkruar komplet, pjesa tjetër ka pësuar ndryshime. Projektligji përbëhet prej 21 kapitujve, derisa ka trajtuar rekomandimin e misionit të vëzhguesve të BE-së dhe faza e dytë rekomandimin e grupeve parlamentare. Nga BE-ja i kemi trajtuar 40 rekomandime që kanë të bëjnë me zgjedhjet nacionale", ka thënë ai.

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka theksuar se kjo nuk është reformë e thellë zgjedhore politike, mirëpo kjo reformë i ka përfillur 95 për qind rekomandimet dhe sugjerimet e Unionit Evropian, Ambasadës Amerikane, organizatave joqeveritare dhe aktorëve të tjerë.

Organizatat e shoqërisë civile Demokraci për Zhvillim (D4D), Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Lëvizja FOL dhe Organizata ÇOHU, pak orë para se të votohet ky projektligj, u kanë drejtuar letër publike deputetëve të Kuvendit lidhur me reformën zgjedhore.

Sipas këtyre organizatave, reforma zgjedhore është padyshim një prej temave më të diskutuara në diskursin politik kosovar, por e cila ka mbetur pa një epilog prej më shumë se një dekade pavarësisht prej iniciativave të shumta. "Ne kundërshtojmë mundësinë e trajtimit të këtij projektligji në procedura të përshpejtuara", është thënë në reagimin e këtyre organizatave.

Sipas këtyre organizatave të shoqërisë civile, projektligji i ri për zgjedhjet, i cili pritet të shqyrtohet si pikë e vetme në seancën e parë të sotme, në njërën anë, përveç teknikaliteteve, përmban edhe ndryshime të cilat besojnë se cenojnë integritetin zgjedhor, në anën tjetër nuk adresojnë çështje të cilat do ta përmirësonin nivelin e përfaqësimit demokratik në Kosovë.

Disa nga ndryshimet më problematike të këtij projektligji kanë të bëjnë me integritetin e kandidatëve, pavarësinë e KQZ-së dhe votat e kandidatëve. "Përshtatshmëria juridike e kandidatëve është ndër ndryshimet më të dëmshme në kuadër të projektligjit, që cenon seriozisht integritetin zgjedhor. Me ndryshimet e propozuara, të drejtë kandidimi nuk do të kenë vetëm ata që janë të dënuar me burgim efektiv prej një ose më shumë vjetësh, duke e barasvlerësuar kriterin për kandidim me atë për humbje të mandatit. Kjo dispozitë ul standardin për aplikim të kandidatëve si dhe ngushton gamën e kufizimeve mbi pamundësinë e kandidimit, duke ua dhënë mundësinë kandidatëve që kanë qenë të dënuar me dënime me kusht, gjobë apo por me më pak se një vit burgim efektiv, për të qenë pjesë e garës zgjedhore. Për më keq, ky ndryshim nuk merr në konsideratë faktin që sistemi gjyqësor i Kosovës shquhet për politikë të ulët ndëshkimore, me ç'rast vetëm në dy vitet e fundit, mbi 80 % e të personave të përfshirë në vepra penale të korrupsionit janë dënuar vetëm me kusht, me gjobë ose me më pak se një vit burgim efektiv. Të gjithë këta individë mund të jenë potencialisht kandidatë apo deputetë në të ardhmen, duke e cenuar seriozisht integritetin dhe imazhin e Kuvendit", është thënë në reagimin e këtyre organizatave të shoqërisë civile.




KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË, EDI RAMA, PËRPIQET TË JAPË KONTRIBUT PËR ASOCIACIONIN, UA DORËZON NJË DRAFT-DOKUMENT FRANCËS DHE GJERMANISË

# Rama propozon draft për Asociacionin: S'mund ta shoh Kosovën të tkurret si shtet

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka bërë me dije se këtë draft-dokument për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë ua ka përcjellë presidentit të Francës, Emmanuel Macron dhe kancelarit gjerman Olaf Scholz. Rama ka theksuar se ky dokument është konfidencial, por u shpreh i bindur se është "një dokument i nivelit më të lartë ndërkombëtar që merr në konsideratë të gjitha arsyet për krijimin e Asociacionit dhe që Asociacioni është pjesë e organizimit të jetës për Kosovën". Ai ka treguar se ky draft është punuar nga ekspertët e lartë amerikanë dhe evropianë prej kohësh

EPOKA E RE Mal QORRAJ

Prishtinë, 8 qershor - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka bërë me dije se ua ka përcjellë një draft për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë presidentit të Francës, Emmanuel Macron dhe kancelarit gjerman Olaf Scholz. "Dje i kam përcjellë presidentit Emanuel Macron dhe kancelarit Olaf Sholz një draft të Asociacionit për të cilin i kam vënë në dijeni presidentin e Këshillit Evropian, Sharl Mishel dhe palën amerikane. Është një draft i punuar nga ekspertët e lartë amerikanë dhe evropianë prej kohësh, gjë që është bërë pikërisht nëse do të vinte kjo ditë, kur palët dhe në këtë rast për mua i pakuptueshëm është pozicioni i Kosovës që bën atë që bën herët e tjera, palët nuk po merren dot vesh as kush do ta shkruajë këtë tekst, jo më çfarë do të ketë ky tekst", ka thënë Rama në një konferencë për medie mbajtur të enjten.

Kryeministri i Shqipërisë ka thënë se ky dokument është konfidencial, por u shpreh i bindur se është "një dokument i nivelit më të lartë ndërkombëtar që merr në konsideratë të gjitha arsyet për krijimin e Asociacionit dhe që Asociacioni është pjesë e organizimit të jetës për Kosovën".

"Ky është një dokument konfidencial që nuk pretendon të jetë zgjidhja ideale, por ju siguroj se ky dokument i nivelit më të lartë ndërkombëtar merr në konsideratë krijimin e Asociacionit dhe është pjesë e furnizimit të jetës në Republikën e Kosovës, duke adresuar të gjithë rekomandimet e gjykatës së Kosovës. Uroj që ky material të vlejë që ta çojë në nivel tjetër dialogun dhe t'i bëjë palët të flasin për gjëra konkrete, për gjëra që lidhen me përfundimin e dialogut. Pse e ndaj publikisht? Sepse situata po bëhet alarmante dhe unë nuk mund të qëndroj spektator e ta shoh Kosovën të tkurret në sytë e atyre që krijuan shtetin e Kosovës", u shpreh Rama.

Ai ka shtuar se drafti është neutral. "Nuk është bërë as për njërën as për tjetrën palë, por për Kosovën. Për mua është Kosova, mbi të gjitha, dhe jam këtu për Kosovën, nuk jam këtu as për njërin as për tjetrin, as për veten time fare. Sepse unë nuk marrë vota në Kosovë dhe nuk kam asnjë interes në Kosovë në aspektin personal, as profesional, as partiak, as politik ngushtësisht. Por si kryeministër i Shqipërisë që sheh se si një pjesë e kombit tim po hyn në një kurs përplasje me ata që e lartësuan kombin tim si asnjëherë më parë dhe hodhën bomba për kombin tim, unë e ndiej detyrë ndaj kombit tim që t'i them këto fjalë", ka thënë Rama.

Marrëveshjen për këtë asociacion Kosova dhe Serbia e kanë arritur qysh në vitin 2013 në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve të ndërmjetësuar nga BE-ja. Por, me gjithë thirrjet e vazhdueshme të komunitetit ndërkombëtar për ta zbatuar atë, Kosova vazhdimisht e ka refuzuar me arsyetimin se kompetencat e gjera të Asociacionit do ta kërcënonin funksionalitetin e brendshëm të shtetit.

Rama ka thënë se nuk është konsultuar për këtë draft me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti.

Rama ka përsëritur se drafti është hartuar nga ekspertë të pavarur, ndërsa ka shtuar se edhe ai vetë ka dhënë kontribut. "Albin Kurtin po e fajëson bota e tërë demokratike dhe kjo më shkakton vetëm keqardhje. Unë nuk jam as për të gjykuar, as sulmuar Albin Kurtin. Po përpiqem të kontribuoj, pasi njëri [Kurti] çon policinë në godina bosh, tjetri [Vuçiq] çon ushtrinë në kufi", ka deklaruar Rama.

Ai ka theksuar se Kurtin e ka mbështetur në procesin e dialogut me Serbinë të ndërmjetësuar nga BE-ja dhe do të vazhdojë ta mbështesë në "rrugën e njohjes së ndërsjellë". "Ndërkombëtarët janë të zotët e shtëpisë në Kosovë, nëse ata ia kthejnë shpinën, mos ndodhtë kurrë, por ajo shtëpi [Kosova] hyn në ditët e saj më të errëta", shtoi ai, duke bërë thirrje që Policia e Kosovës të tërhiqet.

Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje drejt normalizimit të raporteve më 27 shkurt në Bruksel si dhe u pajtuan për Aneksin e zbatimit të saj në Ohër më 18 mars.

Edhe Marrëveshja e Ohrit kërkon që palët t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tani në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve, përfshirë edhe atë për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë.

Qeveria e Kosovës thotë se për të krijuar një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb, do të shtyjë përpara një model kroat për pakicat kombëtare.

Në takim me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, më 2 maj në Bruksel, kryeministri i Kosovës, Kurti, ka propozuar një "draft-vizion" për çështjen e rregullimit të komuniteteve joshumicë, përkatësisht të komunitetit serb në Kosovë.

Një draft-statut për Asociacionin deri më tani ka propozuar edhe Ekipi Menaxhues, i përbërë prej katër pjesëtarëve të komunitetit serb dhe organizata gjermane Friedrich-Ebert-Stiftung (FES).

Në fjalimin e tij, Rama gjithashtu shtoi se është shumë i shqetësuar për situatën në të cilën ndodhet Kosova dhe se nuk dëshiron të përkeqësohet situata apo të vendosen sanksione ndaj saj. "Për mua është i pakuptimtë pozicioni i Kosovës, se Serbia bën atë që ka bërë herë të tjera. Palët nuk po merren vesh kush duhet ta shkruajë këtë tekst e jo më se si duhet hartuar", ka shtuar Rama.

Në veri të Kosovës protestat që po vazhdojnë ende kanë shpërthyer qysh më 26 maj, kur Policia e Kosovës i ka ndihmuar kryetarët shqiptarë të komunave Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq të hyjnë në objektet komunale pavarësisht prej rezistencës së banorëve lokalë.

Për tensionet në veri, përkatësisht mospërfilljen e këshillave të ShBA-së në lidhje me hapat e nevojshëm atje, Kosova është përjashtuar tashmë nga një stërvitje e madhe ushtarake, e udhëhequr nga ShBA-ja në Evropë.

Me gjithë thirrjet e komunitetit ndërkombëtar, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, nuk e ka tërhequr policinë e as kryetarët shqiptarë nga zona veriore e vendit, e banuar me shumicë serbe. "Kam qenë konstruktiv, i përkushtuar, kreativ dhe jam që të gjitha këto, por nuk mendoj se këto gjëra zgjidhen me trysni e me përmendje pasojash, ndoshta edhe sanksionesh të shtetit më demokratik dhe më progresist në Ballkanin Perëndimor. Unë jam i bindur që do të mund t'i sqarojmë paqartësitë. Kemi sfida me emisarët evropianë dhe amerikanë, por marrëdhëniet tona bilaterale me BE-në dhe ShBA-në janë të shkëlqyeshme", kështu u përgjigj kryeministri Kurti kur u pyet nga gazetarët për deklaratën e Escobarit që tha se nëse Prishtina dëshiron të ecë drejt integrimit evropian, ajo duhet ta formojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë.



# Partitë në Kosovë e komentojnë propozimin e Ramës për draftin e Asociacionit

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Armend Muja, ka komentuar deklaratën e kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, i cili ka thënë se i ka dorëzuar një draft të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, presidentit francez Emmanuel Macron dhe kancelarit gjerman Olaf Scholz.

Muja ka thënë se me këtë veprim Rama vetëm sa po e forcon Asociacionin e tij me Vuçiqin. "Duke dërguar statut për 'Asociacionin' në Berlin e Paris, Rama vetëm sa po e shpërfaq dhe forcon Asociacionin e tij me Vuçiqin. Fort i kapur diku për krim e korrupsion duhet të jetë Edi Rama gjersa detyrohet t'ia bëjë këtë mënyrë vetes publikisht para gjithë kombit shqiptar", ka shkruar Muja në "Facebook".

Deputeti nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka mirëpritur propozimin e kryeministrit Rama për këtë draft për Asociacionin, draft të cilin ka thënë se e ka parë. Këtë hap të Ramës, Hoxhaj e ka cilësuar "të rëndësishëm dhe të mirë". Ai ka thënë se shpreson se këtë dokument do ta arrijë në Kuvendin e Kosovës për diskutim të mëtutjeshëm.

Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Arben Gashi, ka thënë se statutin e Asociacionit si dhe menaxhimin me partnerët ndërkombëtarë mund ta bëjë vetëm Qeveria e Kosovës, "askush tjetër". "Të jemi të qartë e të saktë, kompetent për propozimin e statutit të asociacionit, si dhe menaxhimin me partnerët ndërkombëtarë, është vetëm Qeveria e Kosovës, askush tjetër, asnjë qeveri e ndonjë vendi tjetër", ka shkruar në "Facebook" shefi i deputetëve të LDK-së.

Ish-presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka thënë se qeveria shqiptare në asnjë rast nuk duhet të flasë apo të propozojë politika që duhen zbatuar në Kosovë pa u konsultuar paraprakisht me kryeministrin dhe institucionet legjitime të këtij vendi.

E ish-kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, ka thënë se Rama në detyrim doli dhe i informoi shqiptarët se kanë hartuar dhe dorëzuar tekstin e marrëveshjes së Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. Natyrisht vetëkuptohet që teksti është shkruar në Beograd dhe pastaj është rishkruar në Tiranë. Ky akt përbën një ndërhyrje flagrante në punët e brendshme të Kosovës në emër të Beogradit, përbën një akt më të shëmtuarin në historinë e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve", ka thënë Berisha.

# Murati: Ambasadorët dhe emisarët specialë diplomatikë përçojnë qëndrimet zyrtare të Uashingtonit



**Prishtinë, 8 qershor** - Kryetari i Lëvizjes për Bashkim, Valon Murati, ka thënë të enjten se ambasadorët dhe emisarët specialë diplomatikë përçojnë qëndrimet zyrtare të Uashingtonit dhe nuk i krijojnë ato. Sipas tij, të konstatohet se ambasadorët apo emisarët diplomatikë kanë qëndrime të ndryshme nga Uashingtoni zyrtar është injorancë e thellë. "Qëndrimet politike amerikane mund të na pëlqejnë apo jo. Për më tepër këto qëndrime nuk hartohen nga ambasadorët apo emisarët specialë. Ata mund të ndihmojnë në hartimin e tyre, mbi të gjitha ata i përçojnë ato. Sigurisht ngjyra dhe toni sesi ato plasohen mund të dallojnë nga një personalitet te tjetri. Por konstatime të tilla, se ambasadorët apo emisarët diplomatikë kanë qëndrime të ndryshme nga Uashingtoni zyrtar, mund ta dëgjohen këto vitet e fundit me të madhe në kuluaret politike dhe mediatike të Prishtinës dhe të Tiranës. Njëjtë po ndodh këto ditë me qëndrimet e Gabriel Eskobarit. Kjo në rastin më të mirë është injorancë e thellë, në rastin më të keq, sidomos kur vjen nga politikanë, analistë e 'ekspertë', është manipulim i pastër me opinionin publik. Nga kjo e fundit mund të fitojnë në planin afatshkurtër politikanë të caktuar, po nuk fiton Kosova. Të vërtetën duhet ta shohim drejt në sy dhe të ballafaqohemi me të, e jo t'i iket asaj duke manipuluar me opinionin", ka shkruar Murati në "Facebook".

## Zgjedhet kryetari dhe këshilli i fshatrave Shupkovc, Zasellë dhe Cërnushë



MITROVICË, 8 QERSHOR - Janë mbajtur zgjedhjet për kryetar dhe anëtarë të këshillave të fshatrave Shupkovc, Zasellë dhe Cërnushë në Mitrovicë.Në një frymë demokratike, kryetar i këshillit është zgjedhur Nexhat Shabani, ndërsa këshilli i fshatit do të ketë në përbërje gjithsej nëntë anëtarë.
Procesi i përzgjedhjes është realizuar në prani të nënkryetarit të komunës, Arian Tahiri dhe anëtarëve të komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale, Jeton Ujkani, Valbona Sadiku, Majlinda Kurti, Xhyljeta Morina Imeri.
Nënkryetari Tahiri, pasi i uroi suksese kryetarit dhe këshillit të fshatrave, u zotua për bashkëpunim të ngushtë në të mirën e banorëve të fshatrave.

# Opozita në Prishtinë merr nën menaxhim dhjetë ndërmarrjet publike komunale



### Aksionarët e rinj të emëruar nga opozita në dhjetë ndërmarrjet publike në Prishtinë janë:

Gëzim Mehmeti dhe Sami Borovcin në "Termokos"
Arianti Beqiri dhe Besart Krasniqi në "Ndërmarrjen Publike Banesore"
Femi Osmani dhe Petrit Reçica në ndërmarrjen "Pastrimi"
Valbona Ajeti dhe Taulant Maxharraj në ndërmarrjen "Hortikultura"
Triera Kosumi-Berisha dhe Gëzim Sveçla në "Trafikun Urban"
Endrit Zabërgja dhe Bahri Gashi në "Sport Marketing"
Mirsad Vitia dhe Besnik Mujeci në "Stacionin e Autobusëve"
Flamur Kelmendi dhe Besnik Haziri në "Prishtina Parking"
Kushtrim Mushica dhe Endrit Gashi në "Pallatin e Rinisë"
Teuta Kadiu-Gjinolli dhe Arbnora Berisha në "Kuzhina Qendrore"
Këta kandidatë u emëruan me 26 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Partitë opozitare në Kuvendin Komunal të Prishtinës, LV-AAK-Nisma-AKR, pas shkarkimit të 20 aksionarëve të dhjetë ndërmarrjeve publike komunale, kanë emëruar aksionarët e rinj.
Asamblisti Endrit Zabërgja nga Nisma, lidhur me shkeljet në ndërmarrjet publike, ka deklaruar se është koha e fundit të reagojnë. "Në emër të anëtarëve nënshkrues më lejoni ta paraqes arsyetimin për pikën e parë të rendit të ditës. Për parregullsitë, shkeljet ligjore, mosraportimin e rregullt dhe ankesën e qytetarëve në lidhje me këto ndërmarrje. Konsiderojmë se është koha e fundit që të reagojmë. Prandaj propozojmë shkarkimin e aksionarëve në 10 ndërmarrje publike të zgjedhur më 18 mars", ka thënë ai.

# Drejtori i Inspeksionit në Drenas kontrollon ndërtimet e larta në qytet

DRENAS, 8 QERSHOR - Drejtori i Inspeksionit në komunën e Drenasit, Petrit Gashi, së bashku me inspektorë të tjerë, të enjten ishin në kontroll të përbashkët në të gjitha objektet e ndërtimit të lartë në qytet.
Drejtori Gashi është njoftuar nga afër me rrjedhën e punimeve, standardet dhe respektimin e lejeve ndërtimore, kushtet e punës dhe respektimin e ligjeve të ndërtimit nga ndërtuesit në komunën e Drenasit.
Në kuadër të inspektimeve Drejtoria e Inspeksionit edhe një herë ua ka tërhequr vërejtjen të gjithë ndërtuesve se nuk do të lejojnë kompromise me ligjin dhe në çdo hap do të përcillen fazat e ndërtimit, kontrollit të objekteve dhe, njëkohësisht, edhe vëzhgimi i



dëmit të hapësirave publike që të kthehen në gjendje të mëparshme.
Drejtoria e Inspeksionit ka njoftuar se do ta vazhdojë zbatimin e detyrave dhe përgjegjësive që ka në mbikëqyrjen e vazhdueshme të objekteve dhe në respektimin e lejeve ndërtimore. Inspektoret do të mbeten të përkushtuar që të jetë shembull i bashkëpunimit, bashkëveprimit dhe i parandalimit të problemeve të mundshme që mund të hasen gjatë fazës së ndërtimeve.
Drejtoria e Inspeksionit, Petrit Gashi, ka falënderuar qytetarët për bashkëpunimin në respektimin e ligjeve.

# Gjendja e sigurisë në Podujevë, e qetë

PODUJEVË, 8 QERSHOR - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi i Komunës së Podujevës (KKSB) ka mbajtur mbledhjen e rregullt të kryesuar nga kryetari i komunës, Shpejtim Bulliqi, në të cilën ka analizuar gjendjen e sigurisë në komunë dhe ka miratuar ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 27 mars dhe ka diskutuar për çështje të tjera të sigurisë.
Lidhur me çështjen e sigurisë në komunë, raportoi komandanti i Stacionit Policor, Nijazi Jashari, i cili theksoi se gjendja e përgjithshme e sigurisë është mirë, stabile dhe e menaxhueshme.
Jashari në raportin e tij për periudhën 1 janar-31 maj ka thënë se gjatë këtij intervali kohor



është raportuar një rast i vrasjes, tri raste hetim të vdekjes, një rast vrasje në tentativë, 28 raste dhunë në familje, 142 raste aksidente trafiku me dëme material dhe lëndime, 20 raste armë të ndryshme të konfiskuara, 17 lokale të kontrolluara, 23 persona të arrestuar, 315 raste të hapura dhe 97 të zgjidhura.

## Dy organizata ndërkombëtare u dalin në ndihmë të prekurve nga vërshimet në Mitrovicë

MITROVICË, 7 QERSHOR (ER) - Organizata "Help – Hilfe zur Selbsthilfe Kosovo" dhe Fondacioni "Z Zurich" të mërkurën kanë bërë dhurimin e pajisjeve elektro- shtëpiake për 28 familje të cilat janë prekur nga vërshimet në Mitrovicë.
Me rastin e dhurimit të këtyre pajisjeve mori pjesë drejtori i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, Elvis Feka dhe përfaqësuesja nga "Z Zurich Foundation", Afërdita Gjoklaj.
Ky donacion përmbante mjete elektrike shtëpiake si: frigorifer, shporet elektrik, shporet me dru dhe rrobalarëse. Me këtë rast, drejtori Feka ka falënderuar organizatën gjermane "Help" dhe Fondacionin "Z Zurich" për ndihmën e dhënë ndaj këtyre familjeve, si dhe ka shprehur gatishmërinë për të bashkëpunuar në projekte të ndryshme që kanë të bëjnë në mirëqenien e qytetarëve dhe zhvillimin ekonomik të qytetit.



## Kurti pranon tabelën e një rruge në Nju-Jork që mori emrin e Ismail Qemalit




PRISHTINË, 8 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur të enjten në takim veprimtarin dhe aktivistin e njohur për çështjen shqiptare, Naser Nika. Në këtë takim shumë miqësor kryeministri Kurti falënderoi Nikan për kontributin dhe punën e tij të madhe që ndërlidhet me vendin e popullin tonë, duke qenë zë i fortë i mërgatës sonë shqiptare në ShBA.

Nika i dhuroi kryeministrit Kurti një certifikatë mirënjohjeje nga kongresmenja Nicole Malliotakis, përfaqësuese e distriktit të 11-të të Nju-Jorkut. Aktivisti Naser Nika njihet, po ashtu, për iniciativën e tij që një rrugë në Staten Island në Nju-Jork ka marrë emrin e një nga personaliteteve më të shquara të kombit shqiptar, Ismail Qemali, rrugë kjo e cila është inauguruar ditë më parë.

# Agjencia e Kosovës për Akreditim për herë të parë bëhet me ligj

EPOKA E RE Faton DËRMAKU




PRISHTINË, 8 QERSHOR - Për herë të parë që prej themelimit, Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) bëhet me ligj. Një ditë më parë në Kuvendin e Kosovës është votuar Ligji për Agjencinë e Kosovës për Akreditim.

AKA-ja përmes një komunikate për medie ka theksuar se miratimi i këtij ligji garanton pavarësinë institucionale dhe financiare të saj, ndikon drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë në arsimin e lartë, internacionalizimin e sistemit tonë të arsimit dhe hap rrugë për kthimin e AKA-së në Asociacionin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe Regjistrin Evropian për Rritje të Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR).

Ky ligj është miratuar pas një pune të gjatë dhe me përkushtim të grupeve punuese të MAShTI-t, Komisionit për Arsim të Kuvendit të Kosovës dhe vullnetit politik për përkrahje të pavarësisë së AKA-së.

Kryetarja e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC), profesoresha Hasnije Ilazi dhe drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), Naim Gashi, që kanë marrë pjesë në takime të shumta të grupeve punuese, e kanë mirëpritur miratimin e Ligjit për AKA-në.

Kryetarja Ilazi dhe drejtori Gashi, në emër të KShC-së dhe AKA-së, falënderojnë ministren e MAShTI-t, Arbërie Nagavci, Qeverinë e Kosovës, anëtarët e Komisionit për Arsim të Kuvendit dhe kryetarin e këtij komisioni, Ardian Gola, deputetët e Kuvendit të Kosovës, Zyrën e Komisionit Evropian në Prishtinë, Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, donatorët ndërkombëtarë, shoqërinë civile, komunitetin akademik, studentët dhe mediet për kontributin e tyre në arritjen e këtij suksesi të përbashkët.

Ligji për AKA-në është një tregues për ekzistimin e një kohezioni nacional për cilësinë në arsimin e lartë. Kosova është vendi i parë në Ballkanin Perëndimor që ka ligj për akreditim dhe kjo është një arritje e madhe, e cila i vendos AKA-në dhe Kosovën si lidere në rajon sa i përket ngritjes së cilësisë në arsimin e lartë.

# Musliu: Kosova po e përjeton eksodin më të madh të historisë së saj si pasojë e keqqeverisjes



PRISHTINË, 8 QERSHOR - Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ganimete Musliu, ka kritikuar qeverinë Kurti për mosveprim ndaj emigrimit masiv të qytetarëve të Kosovës. "Sot ne kemi një qeveri e cila çdo ditë e më shumë po e gropos përfundimisht shpresën e qytetarëve dhe po e fakton se ndryshimin që e propaganduan e sollën, por e sollën për keq. Si rezultat i gjithë kësaj, me një politikë kaotike dhe pa përmbajtje në sfond, qytetarët tanë kanë marrë botën në sy. Kosova po e përjeton eksodin më të madh të historisë së saj. Po e përjeton në heshtje sepse tematizimi i tij nuk është në favor të qeverisë", ka thënë deputetja Musliu në seancën e së enjtes të Kuvendit.

Ajo ka theksuar se emigrimi është revoltë e një populli kundër politikëbërjes dhe kundër arrogancës së pushtetit si rezultat i së cilës Kosova sot ndodhet në mes të një katastrofe sociale kombëtare. "Mjekë, mësues, ushtarë, policë, zjarrfikës, bankierë, avokatë, sipërmarrës, shtresat e mesme të arsimuara, qytetarë të cilët do të preferonin të qëndronin dhe të ndërtonin të ardhmen e tyre në Kosovë, sot, për shkak të bastardimit të sistemit dhe për shkak të zhvlerësimit të tyre profesional dhe personal, kanë zgjedhur ta braktisin vendin", ka thënë Musliu.

## Sekretari i Kuvendit pensionohet, Haradinaj i jep mirënjohjen 'Me besim në Zot, Atdhe e Shtet'

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Deputetët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e kanë pritur në takim lamtumirës sekretarin e Kuvendit të Kosovës, Ismet Krasniqi, i cili nesër del në pension. Grupi parlamentar i AAK-së e ka falënderuar Krasniqin për punën 17-vjeçare në tempullin e demokracisë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kryetari i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, duke e falënderuar për punën e tij, theksoi se angazhimi i Krasniqit në të gjitha etapat, që nga shpallja e pavarësisë, në periudhën e mbikëqyrjes ndërkombëtare, në mbështetjen e tij për kalimin e ligjeve vitale për vendin, si Ligji për Ushtrinë, ka bërë që kryetari Ramush Haradinaj t'i japë mirënjohjen "Me besim në Zot, Atdhe e Shtet".



# Komisioni i aksionarëve të NPB-s vendos për "Projektin në Lakrishtë"

**Prishtinë, 8 qershor** - Në mbledhjen e Komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Banesore (NPB), i përbërë nga Vllaznim Osmani, aksionar i kryetarit të komunës së Prishtinës, Granit Geci dhe Leutrim Retkoceri, aksionarë të Kuvendit Komunal të Prishtinës, është diskutuar lidhur me zhvillimet e fundit në NPB. "Kjo mbledhje vjen pas disa analizave dhe hulumtimeve të fakteve që ka bërë Komisioni në lidhje me kontratën për ndërtimin e projektit në Lakrishtë, e cila disa herë është kontestuar nga një parti e caktuar duke iu adresuar formës dhe instancave gjyqësore të gabuara, qoftë kjo me qëllime të caktuara apo si pasojë e mosdijes. Komisioni thekson se ka zgjedhur rrugën e duhur ligjore për të kontestuar këtë kontratë dhe për të njëjtën nuk do të ndalet deri në arritjen e qëllimit të vërtetë të ruajtjes së interesit publik dhe në interes të Ndërmarrjes Publike Banesore", ka njoftuar NPB-ja.

Pas pranimit të opinionit ligjor nga zyra ligjore, përmes të cilit është dhënë konkluzioni se Rregullorja për Rritjen e Pasurisë së Paluajtshme të Ndërmarrjes Publike Banesore përmes ndërtimit është në kundërshtim me legjislacion përkatës në fuqi, aksionarët, pas shqyrtimit dhe analizimit të fakteve dhe opinionit në fjalë, kanë nxjerrë vendim përmes të cilit anulohet vendimi me numër protokolli 01-586/1, i datës 27.04.2021, i Komisionit Komunal të Aksionarëve, për miratimin e draft marrëveshjes kryesore për bashkinvestim të prezantuar në mbledhjen e datës 22.4.2021 nga ish-kryeshefi ekzekutiv. "Komisioni kërkon nga Bordi i Drejtorëve ta shfuqizojë Rregulloren për Rritjen e Pasurisë së Paluajtshme të Ndërmarrjes Publike Banesore përmes ndërtimit nr. prot. 01-1311/1, datë 07.12.2020, në bazë të opinionit ligjor të datës




29.05.2023, i nxjerrë nga komuna e Prishtinës përmes të cilit konstatohet se e njëjta është e paligjshme. Komisioni konstaton se obligohet Bordi i Drejtorëve që në koordinim me zyrën ligjore dhe me KE-në të ndërmarrin hapat e nevojshëm ligjorë lidhur me kontratën LRP. nr. rendor 4791/2021, Ref: 955/2021 e datës 17.05.2021 dhe të gjitha anekset e kësaj kontrate. Po ashtu, obligohet Bordi i Drejtoreve që të kërkojë nga departamentet përkatëse në NPB të bëjnë një vlerësim të dëmeve që ka shkaktuar kontrata dhe konform gjetjeve ta iniciojnë procedurën ligjore për kompensim dëmi dhe t'i njoftojë organet e rendit për dëmet e shkaktuara. Ky vendim i Komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Banesore është në fuqi qysh në momentin e nxjerrjes dhe prodhon efekte juridike", ka theksuar NPB-ja.

# Oda Ekonomike Amerikane paralajmëron Kosovën: Tensionet pengojnë investimet

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

**Prishtinë, 8 qershor** - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë përmes një deklarate për medie ka kërkuar nga qeveria ta demonstrojë përkushtimin ndaj partnerëve ndërkombëtarë me qëllim të shtensionimit të situatës në veri të vendit, e cila, siç thuhet, ka pasoja të rënda në sektorin privat dhe prospekte të tërheqjes së investimeve të huaja. "Zgjidhja e tensioneve dhe nxitja e një mjedisi paqësor dhe stabil janë thelbësore për krijimin e një mjedisi të favorshëm afarist që mund të tërheqë investime dhe ta mbështesë rritjen e qëndrueshme ekonomike në Kosovë. Investitorët kërkojnë mjedise të qëndrueshme dhe të sigurta për bizneset e tyre, ndërsa tensionet e vazhdueshme mund ta minojnë besimin në prospektet ekonomike të Kosovës. Tensionet dhe përplasjet krijojnë një atmosferë pasigurie dhe paparashikueshmërie, e cila i pengon investitorët e mundshëm. Prandaj, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë shpreh shqetësimet e saj për zhvillimet e fundit dhe mungesën e vullnetit të Qeverisë së Kosovës për t'i koordinuar përpjekjet e saj me partnerët ndërkombëtarë, përfshirë ShBA-në dhe BE-në", thuhet në komunikatën e kësaj ode.

Oda Amerikane ka theksuar se Shtetet e Bashkuara kanë qenë një mbështetëse e palëkundur e




pavarësisë së Kosovës dhe kanë luajtur rol kyç në krijimin e saj si shtet sovran. "Përmes përpjekjeve diplomatike, ShBA-ja ka avokuar vazhdimisht për njohjen e Kosovës nga bashkësia ndërkombëtare, duke promovuar integrimin e saj në institucionet globale dhe duke nxitur zhvillimin e saj ekonomik dhe politik. Po ashtu, ShBA-ja ka qenë partner jetik për avancimin e aspiratave të Kosovës për integrim evropian, duke avokuar për liberalizimin e vizave dhe duke mbështetur përparimin e vendit drejt anëtarësimit në BE. ShBA-ja është treguar numër një në botë për produktet e Kosovës, ndërsa në të njëjtën kohë shumë kompani amerikane kontribuojnë në mënyrë aktive në zhvillimin ekonomik të vendit në sektorë si ndërtimi dhe patundshmëria, energjia, shëndetësia dhe teknologjia informative. Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës vazhdon të ofrojë mbështetje direkte financiare për Kosovën përmes Agjencisë së saj për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC)", thuhet në këtë komunikatë.

Më tej theksohet se: "Në mënyrë të ngjashme Bashkimi Evropian luan një rol vendimtar në mbështetjen e zhvillimit politik dhe ekonomik të Kosovës, duke ofruar ndihmë financiare, ekspertizë teknike dhe udhëzime për reforma në sektorë të ndryshëm. Qasja në fondet dhe programet e BE-së lehtëson zhvillimin e infrastrukturës, krijimin e vendeve të punës dhe përmirësimin e shërbimeve publike. Prandaj, duke marrë parasysh ndikimin që ka situata aktuale në zhvillimet socio-ekonomike në përgjithësi, dhe në sektorin privat dhe përpjekjet për tërheqjen e investimeve në veçanti, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë kërkon nga Qeveria e Kosovës që menjëherë t'i marrë parasysh thirrjet nga ShBA-ja dhe BE-ja për shtensionimin e situatës në veri të vendit".

## Afër dhjetë mijë banorë të fshatrave të Skenderajt përfitojnë nga rrjeti i ri elektrik

**Skenderaj, 8 qershor** - Në kuadër të planit investiv të KEDS-it, afër dhjetë mijë banorë të komunës së Skenderajt tashmë janë bërë me rrjet të ri elektrik. Projekti i investimeve në daljen 10kV Likovci, në komunën e Skenderajt, prej të cilit përfitojnë katërmbëdhjetë fshatra, ka përfunduar para pak kohësh. Në këtë linjë të re të Tensionit të Mesëm dhe të Ulët të rrjetit elektroenergjetik janë vendosur 1 450 shtylla të reja të betonit dhe mbi 72 000m përçues elektrikë si dhe 27 transformatorë të rinj. Me vënien në funksion të kësaj linje të re, tashmë po përfitojnë afër 10 000 banorë të asaj komune.

Menaxheri i projektit në daljen 10kV Likovci, Burim Llugaxhiu, inxhinier në KEDS, ka thënë se ky projekt ka qenë i domosdoshëm me qëllim që konsumatorët tanë të kenë furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike. "Konsumatorët tanë të kësaj zone, përveçse kanë cilësi të lartë dhe furnizim pa ndërprerje me energji elektrike, po përfitojnë edhe në aspektin e sigurisë dhe shëndetit, meqë rrjeti i vjetër elektrik është zëvendësuar komplet me një rrjet të ri", ka thënë Llugaxhiu. Banorët e kësaj ane shprehen të lumtur për rrjetin e ri elektrik.

Ejup Gashi nga fshati Krushevc i Skenderajt ka theksuar se më parë nuk ka pasur shtylla të mjaftueshme dhe, edhe ato që kanë qenë, për shkak të vjetërsisë, dëmtoheshin.



# Heroi semantik i shqiptarëve të çdo kohe



Nga: **Aurel PLASARI** (pjes° nga vepra Sk°nderbeu. Një histori politike, Tiran 2010, fq. 828-829)

Duke iu druar pra rrezikut që u përshkrua – rrekjes për t'i mëveshur historisë aftësi parathënëse – në "konkluzionet" e kësaj historie politike Skënderbeu në relacion me mbasardhësit theksohet si hero semantik. Për autorin e kësaj historie kjo do të thotë që, prej gjithë asaj çfarë Skënderbeu përftoi me një vizion gjenial të rrethanave, diçka mbeti. Nuk është fjala për "mësime", por për atë diçka – sema – që do të zhvillohej dhe u zhvillua historikisht qoftë edhe në forma nga më të larmishmet, siç ndodh në çdo fushë të vështruar semantikisht si sistem shenjash.

Përtej rezultatit të realizimit të formacionit politiko-fetar që Šufflay dhe Jirečeku e quajtën "shteti më i madh i krishterë të Ballkanit", si dhe përtej amortizimit të impaktit turko-osman ndaj Europës, në rastin e Skënderbeut edhe arbërorët e tij, si popull bashkëndihmues në qëndresën dhe në luftërat antiturke, e ndien veten kryekëput europianë. Me të tjera fjalë: e ndien veten pjesëdhënës e pjesëmarrës të një sistemi të përbashkët të menduari e të vepruari. Madje Šufflay ka pasë dalë në përfundimin se ishin pikërisht "luftërat e Skënderbeut" ato që i dhanë shkas formimit në mbarë Europën të konceptit të një "Arbërie më vete", e cila për të kishte indicie të këtë vijuar deri në shek. XVII (Šufflay, Das mittelalterliche Arbanien, 285).

Do të thotë kjo që, mbi një konstruksioni që sot mund të na duket thjesht "fetar", erdhi e u ngrit në ato kontingjenca një konstruksion i mirëfilltë politik. Ky është një fakt që në historinë e Europës nuk mund të shuhet, si dhe që në historinë e Arbërisë – edhe në u rrekshin – nuk do ta fshijnë dot. Askush, as ndër arbërorët modernë, nuk do të mundë t'i shpëtojë më ngashënjimit nga ky mnesis politik që rihet e përtërihet prej njërit shekull në tjetrin: është fjala jo për kujtimin e asaj që u quajt Arnavudi ose Arnawutluk, por për Arbërinë e kohës skënderbegiane. "Gjithçka dëfton se deri në pushtimin osman Arbëria kishte ndjekur zhvillimin civil të Europës së [atyre] kohëve", ka pas vënë re Francesco Chetta-Schiròi në hyrjen e një punimi të tij rreth familjes së Kastriotëve (Chetta-Schirò, I Castriota, 1).

Te specialistë të Mesjetës ballkanike, si Gelcich, Jorga, Šufflay, Jireček etj., gjenden dendur përshkrimet e kancelarive të zhvilluara të dinastëve arbërorë, si dhe të dhëna për "shkallën mesatarisht të lartë" të viseve ku ata sundonin, për nivelin e tyre të arsimimit, deri edhe përcaktime si: "feudalët arbërorë ishin të barabartë me bujarinë e lartë të Italisë" (Šufflay, Povijest, 14-18, 28 etj.). Dhe, ç'është e vërteta, do të rezultonte e pamundur që në marrëdhënie të qëndrueshme me Bizantin, nga njëra anë, si dhe me Republikën e Venedikut, me Mbretërinë e Napolit dhe/ose të Dy Siqelive etj., nga tjetra, Arbëria e atyre kohëve të mos funksiononte mes influkseve të qendrave të kulturës, artit, tregtisë së Europës.

Pa përfilljen e këtij konstruksioni të ri, asokohe në përftim e sipër, nuk do të kuptohej dot pozicioni i arbërorëve në raport me kontinentin europian jo vetëm gjatë periudhës së luftërave antiturke të udhëhequra nga Gjergj Kastrioti, – sikurse në këtë histori politike u dëftua, – por edhe mbas tyre, kur arbërorët t'i përfshiheshin përdhunshëm njësisë së re perandorake që do të instaurohej gjatë shekujve XVI-XIX në Juglindjen europiane: Perandorisë osmane. Në një kontekst si ky qëndresa dhe luftërat antiturke të Skënderbeut ngrenë peshë si për ç'i përket përfshirjes së tij në historinë e madhe të Europës, ashtu edhe për pozicionin ndërkombëtar në të cilin, në kapërcyellin e Mesjetës dhe Kohës së Re, ai e vendosi Arbërinë e tij. Prej një kësi pozicioni ai vetë rezulton jo vetëm personaliteti më i madh politik e ushtarak i historisë së Arbërisë, jo vetëm figura arbërore më e spikatur e historisë së Europës së kohës së tij, por edhe heroi semantik i shqiptarëve të çdo kohe.




Sport


Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

# Kurti: Majlinda, simbol i suksesit në Kosovë dhe kampione e përjetshme



"Epoka e re"

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, të enjten përmes një postimi në "Facebook", ka thënë se Majlinda Kelmendi është simbol i suksesit në vendin tonë. Shefi i ekzekutivit të mërkurën në kuadër të programit "Kosova, Shtet i Xhudos", ishim pjesëmarrës në aktivitetin demonstrues të kampiones olimpike, Majlinda Kelmendi, në palestrën e qytetit të Mitrovicës "Minatori", e cila ishte mbushur përplot me nxënës entuziastë për ta takuar Majlindën. Sportistja më e suksesshme në Kosovë së bashku me xhudistë të tjerë demonstruan teknika profesionale të sportit të xhudos. "Majlinda Kelmendi është simbol i suksesit në Republikën e Kosovës. Qëndrueshmëria ndaj vështirësive, përkushtimi për triumf, dhe modestia e saj ndaj suksesit - janë tri virtyte të Majlindës të cilat e bëjnë atë: kampione në tatami, kampione në jetë dhe kampione përjetë. Përmes programit të xhudos, përveç që po sigurojmë zhvillimin e sportit në vend, njëkohësisht po krijojmë mundësi për të rinjtë tanë që ta shprehin talentin e tyre, të jenë aktivë dhe të shëndetshëm si dhe të jenë të suksesshëm. Uroj që shumë të tjerë ta ndjekin rrugën e suksesit të Majlindës, Norës dhe Distrias. Kosova është shtet i xhudos!", ka shkruar Kurti. Ndërsa trajneri Driton Kuka ka thënë se Majlinda Kelmendi ishte figura kryesore e demonstrimit në palestrën "Minatori" në Mitrovicë. "Para mijëra fëmijëve Majlinda demonstroi mjeshtëritë e saj për t'i inkurajuar të rinjtë të merren me sportin e xhudos. Përmes sportit të bukur të xhudos ajo tregoi dhe u përgjigj në mënyrën më të bukur se si duhet të sillen sportistët elitarë", ka deklaruar Kuka.

Të pranishëm në demonstrim e Majlinda Kelmendit, përveç kryeministrit Kurti, ishte edhe zëvendësministrja e Sportit, Daulina Osmani, nënkryetari i komunës së Mitrovicës, Arian Tahiri. "Kosova - Shtet i xhudos" është projekt që tashmë ka përfshirë mbi 20 mijë fëmijë në mbarë Kosovën.

## SHKURT

### KF Ulpiana vazhdon bashkëpunimin me trajnerin Emin Bajrami

KF Ulpiana e ka vazhduar bashkëpunimin edhe për një vit tjetër me trajnerin e mirënjohur Emin Bajrami. Ky klub e ka konsideruar edicionin e sapo përfunduar si të suksesshëm, prandaj edhe ka vendosur të vazhdojë bashkëpunimin me trajnerin Bajrami. "Është arritur marrëveshja në mes të presidentit Jeton Gashi dhe trajnerit Emin Bajrami që të vazhdohet bashkëpunimi edhe për një vit me mundësi vazhdimi, ku sezoni që lamë pas ishte mjaft i suksesshëm, dhe kjo e shtyri të ketë marrëveshje mes palëve", thuhet në njoftimin e skuadrës së Ulpianës.

### Liria synon transferimin e ish-sulmuesit të Monacos dhe Evertonit

Liria e Prizrenit duket se e ka marrë seriozisht kthimin në Superligën e Kosovës. Prizrenasit kanë arritur marrëveshje me sulmuesin e njohur, Lacina Traore. Sipas raportimit të "Indeksonline", Liria ka arritur marrëveshje me ish-partnerin e Kylian Mbappes në sulmin e Monacos, Lacina Traore, i cili do të jetë vetëm përforcimi i parë për Lirinë. Lacina Traore ka qenë për disa vjet emër i njohur në futbollin evropian. Sulmuesi afrikan ka qenë pjesë edhe e Premierligës Angleze si futbollist i Evertonit. Edicionin e kaluar 33-vjeçari luante në Portugali te skuadra e Varzimit.

### Rilindja 1974 ndërpret bashkëpunimin me Papuqin

Klubi nga Liga e Parë e Kosovës, KF Rilindja 1974, e ka ndërprerë bashkëpunimin me trajnerin e deritashëm Fisnik Papuqi. "KF Rilindja 1974 njofton se në mënyrë të dyanshme ka shkëputur marrëveshjen me trajnerin Fisnik Papuqin. Rilindja 1974 falënderon trajnerin për udhëheqjen e klubit, duke i uruar suksese në të ardhmen", thuhet në njoftimin klubit nga Lugu i Baranit. Kjo skuadër e papërfunduar kampionatin në Ligën e Parë - A në pozitën e shtatë me 32 pikë.

### Zidane refuzon edhe një herë PSG-në

Zinedine Zidane e ka refuzuar edhe një herë tjetër Paris Saint-Germain. Trajnerit francez i është kërkuar ta marrë drejtimin e klubit parisien, por ai e ka refuzuar këtë, raporton "Le Parisien". Klubi nga "Parku i Princave" dëshiroi ta zëvendësonte Galtierin me Zidane, por kjo nuk u pranua nga ky i fundit. Zidane shkroi historinë me Real Madridin, por që nga largimi nuk ka marrë drejtimin e ndonjë skuadre tjetër.

## Më 12 qershor seminar për trajnerët e Superligës dhe Ligës së Parë

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Bordi i Shoqatës së Trajnerëve të Futbollit të Kosovës organizon seminarin e radhës për trajnerët e futbollit të klubeve të AlbiMall Superligës dhe "Viva Fresh" Ligës së Parë. Në fakt, ky seminar është vazhdimësi e seminarit teorik të mbajtur në muajin shkurt. Tani seminari do të jetë i përqendruar në pjesën praktike. Pjesëmarrja në seminar është e obligueshme për trajnerët e AlbiMall Superligës dhe "Viva Fresh" Ligës së Parë, derisa pjesëmarrja e trajnerëve të ligave të tjera është e mirëseardhur. Seminari mbahet më 12 qershor, në orën 10:00, në Kampin Nacional në Hajvali.



## Ancelotti kritikon Milanin për shkarkimin e Maldinit: Të destinuar për dështim

MADRID, 8 QERSHOR - Trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, ka thënë se klubet që i japin përparësi biznesit mbi meritat sportive janë të destinuara të dështojnë dhe beson se shkarkimi i Paolo Maldinit nga pronarët e Milanit dëshmon mungesë të kulturës historike dhe mungesë respekti për traditën e Milanit.
Trajneri italian foli pas vendimit të drejtuesve të Milanit për ta shkarkuar ikonën e klubit, Paolo Maldini. "Në Madrid kam mësuar se historia duhet respektuar gjithmonë", ka thënë Ancelotti kur u pyet për shkarkimin e Maldinit. "Këtu, Di Stefano, Amancio, Gento dhe Puskas, janë vlera ekskluzive që ende respektohen. Ajo që ndodhi me Maldinin dëshmon mungesën e kulturës historike dhe mungesën e respektit për traditën e Milanit. Është e vërtetë që nuk fitohet me histori, por historia mëson se si të fitosh. Klubet e futbollit që mendojnë për prioritetet e biznesit para meritave sportive janë të destinuara të dështojnë", ka shtuar Ancelotti.
Maldini luajti 252 ndeshje të Milanit nën drejtimin e Ancelottit, duke shënuar shtatë gola dhe duke fituar, mes trofeve të tjera, dy herë Ligën e Kampionëve.



# Asnjë skuadër nuk i hap dyert për Mick Schmacher

STUTTGART, 8 QERSHOR - E ardhmja e pilotit gjerman Mick Schmacher, djalit të shtatë herë kampionit të botës në Formula 1, Michael Schumacher, rrezikon të jetë sërish e paqartë në dhjetor. Këtë sezon ai është piloti rezervë i Mercedesit, me shpresën që vitin tjetër (2024) të rikthehet në pistë si pilot i parë. Pas largimit nga Haas (garoi për dy sezone) dhe pasi Akademia Ferrari i mbylli dyert, piloti i ri gjerman pranoi të jetë pilot rezerv i Mercedesit. Sipas shefit të makinës gjermane, ka shumë gjasa që Mick Schumacher ta vijojë këtë detyrë edhe vitin tjetër, me ata apo me ndonjë skuadër tjetër. "Situata është mjaft e vështirë këtë vit edhe pse do të dëshiroja shumë që Mick të gjente një makinë për të garuar vitin tjetër. E meriton një gjë të tillë, por situata për vitin 2024 nuk është në favorin e tij. Mendoj se vetëm në vitin 2025 do të ketë mundësi konkrete", ka thënë Toto Wolff.
Edhe vetë Mercedesi nuk mund t'i ofrojë më shumë se kaq, teksa prej kohësh ka nisur bisedimet për rinovimin e kontratës me Lewis Hamiltonin, që do të thotë se mund të jetë sërish pilot rezervë te Mercedesi në rast se nuk i ofrohet ndonjë vend i lirë për t'u rikthyer në pistë si pilot i parë.




# Denveri në epërsi ndaj Miamit

Denver, 8 qershor - Denver Nuggetsi ka fituar në udhëtim ndaj Miami Heat me rezultat 109-94 në ndeshjen e tretë finale të "play-off"-it në NBA. Përballja e tretë e zhvilluar në "Kaseya Center" i ka takuar Denver Nuggetsit, i cili ka rikthyer epërsinë në finale me rezultat 2-1. Çereku i parë i ndeshjes ishte krejtësisht i barabartë, duke përfunduar me rezultat 24-24, ndërsa në çerekun e dytë Nuggetsi ishte për një nuancë më i mirë. Mysafirët arritën ta fitojnë 12-minutëshin e dytë me rezultat 29-24, duke shkuar në pushim me epërsi prej pesë pikësh apo rezultat 53-48. Në çerekun e tretë Nuggetsi vazhdoi lojën e mirë dhe ngriti epërsinë, pasi fitoi 29-20 dhe çoi rezultatin në 81-68. Edhe 12-minutëshi i fundit foli në të mirë të mysafirëve pasi fituan me rezultat 27-26 apo me rezultat të përgjithshëm 109-94. Dy lojtarët më të dalluar të Nuggetsit ishin Luka Jokiq me 32 pikë, 21 kërcime e 10 asistime dhe Jamal Murray me 34 pikë, 10 kërcime e 10 asistime. Te Miami më të dalluarit ishte Jimmy Butler me 28 pikë dhe Bam Adebayo me 22 pikë e 17 kërcime. Ndeshja e katërt zhvillohet pas dy ditësh apo, më saktë, në mëngjesin e së shtunës.




SHKURT

## Mazrekaj, afër marrëveshjes me Strugën

Mentor Mazrekaj ishte një nga lojtarët më të mirë të skuadrës së Laçit, por 34-vjeçari ka vendosur të largohet nga kampionati shqiptar. "SuperSport" raporton se sulmuesi i majtë do të jetë pjesë e Strugës, skuadër e cila fitoi titullin kampion këtë edicion në Maqedoninë e Veriut. Futbollisti "dardan" ka arritur marrëveshje me drejtuesit e Strugës për të nënshkruar për një vit, teksa pritet që të premten të bëhet zyrtarizimi. Ai do të vihet menjëherë nën urdhrat e trajnerit Shpëtim Duro pasi ta firmosë kontratën me klubin shqiptar. Tekniku kryeqytetas e njeh mjaft mirë Mazrekajn, pasi e ka pasur në skuadër në kohën kur ishte pjesë e Partizanit dhe Laçit. Lidhja mes tyre është e veçantë. Dhe ishte pikërisht Duro që insistoi të transferohej te bardhezinjtë, ndonëse lojtari ofensivë ishte larguar nga futbolli.

## Ronaldo: Do të luaj edhe 2-3 vjet, pastaj do të blej një klub

Me rastin e një ngjarje përuruese për ujin "Alkaline Ursu", Cristiano Ronaldu u rikthye në Madrid ku mbajti një konferencë për shtyp në të cilën foli edhe për të ardhmen e tij. "Më kanë mbetur edhe 2-3 vjet karrierë. Në këtë moshë është akoma më e rëndësishme të kujdesesh për veten. Nuk do ta përjashtoja blerjen e një klubi futbolli. Është diçka që do të doja ta bëja sapo të mbaronte karriera ime si lojtar", ka thënë Ronaldo.

## Lazio synon transferimin e Jorginhos

Objektivi për mesfushën e Lazios quhet Jorginho. Mesfushori i Arsenalit është më shumë se një ide për skuadrën kryeqytetase që dëshiron t'i japë Maurizio Sarrit një organizator për sezonin e ardhshëm. Siç raportohet nga "Gazzetta dello Sport", pengesa përfaqësohet nga paga që lojtari italian merr, 6.5 milionë euro në sezon. Zgjidhja mund të jetë ofrimi i një shifre më të ulët, jo më shumë se 4 milionë euro, me një kohëzgjatje më të gjatë të kontrate.

## Neymari pranon uljen e pagës për të kaluar në Barcelonë

Barcelona ka humbur mundësinë për të nënshkruar me Lionel Messin këtë verë, por tash mund të nënshkruajë me yllin tjetër të PSG-së, Neymar. Futbollisti brazilian i është vetofruar Barcelonës për sezonin e ardhshëm 2023/24. Marrëdhëniet e Neymarit me PSG-në janë përkeqësuar në sezonet e fundit, është i gatshëm të bëjë një ulje drastike të pagës në mënyrë që të kthehet në klubin që u largua në vitin 2017. Tani 31 vjeç, ai do t'i siguronte ndoshta nivelin më të afërt të krijimtarisë për Messin, nëse ai do t'i bashkohej. Ai është, gjithashtu, i aftë të shënojë gola, diçka që vetëm Robert Lewandowski ka mundur ta bëjë për Barcelonën këtë sezon.

## Allister: Një ëndërr e realizuar kalimi në Liverpool

Liverpooli ka njoftuar se e ka transferuar Mac Allister. 24-vjeçari ka përfunduar me sukses testet mjekësore dhe ka rënë dakord për kushtet personale për t'u bërë nënshkrimi i parë i Liverpoolit në këtë afat kalimtar. Allister do të arrijë në "Anfield" më pak se gjashtë muaj pas shpalljes kampion me Argjentinën në Kupën e Botës në Katar dhjetorin e kaluar, duke mbyllur një sezon shumë mbresëlënës me Brightonin. "Ndihet e mrekullueshme. Është një ëndërr e realizuar, është e mrekullueshme të jesh këtu dhe mezi pres të filloj. Doja të isha [që nga] dita e parë e para-sezonit, kështu që është mirë që gjithçka është bërë. Mezi pres t'i takoj shokët e skuadrës. Ishte një vit fantastik për mua - Kupa e Botës, ajo që arritëm me Brightonin, por tani është koha të mendojmë për Liverpoolin dhe të përpiqemi të jemi një lojtar më i mirë dhe një qenie njerëzore më e mirë çdo ditë", ka thënë Allister.

UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. nr. 02/1079/ Dt. 08/06/2023

## Konkurs për rektor të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan

Në bazë të nenit 19, paragrafi 1, të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës dhe nenit 23 parag.1 nënparag.1.9 dhe nenit 27 të Statutit të Universitetit, Këshilli Drejtues i Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan në mbledhjen e mbajtur më 07.06.2023, mori vendim për shpalljen e konkursit për:

**Rektor të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan**

**Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet si në vijim:**

1. Të ketë përvojë të dëshmuar në mësimdhënie akademike, kërkime shkencore dhe të ketë gradën e profesorit të rregullt, profesorit të asociuar ose profesorit asistent.
2. Të ketë përvojë të dëshmuar menaxhuese universitare.

**Procedura e përzgjedhjes:**

- Konkurrimi për postin e rektorit është i hapur për kandidatët e brendshëm dhe të jashtëm.
- Komisioni profesional, i zgjedhur nga Senati, i propozon Këshillit Drejtues listën e kandidatëve të cilët i kanë plotësuar kushtet e konkursit për t`u zgjedhur.
- Këshilli Drejtues i interviston kandidatët që i kanë plotësuar kushtet për konkurrim në këtë post. Në këto intervista, secili kandidat prezanton një vizion gjithëpërfshirës për zhvillimin e strategjisë së ardhshme të Universitetit dhe për qasjen e tij menaxhuese.
- Rektorin e zgjedh Këshilli Drejtues nga lista e kandidatëve të propozuar nga Komisioni profesional prej pesë (5) anëtarëve. Komisioni profesional ka për detyrë që të verifikojë nëse kandidatët e paraqitur për pozitën e rektorit i plotësojnë kushtet e parapara me konkurs.
- Këshilli Drejtues ka të drejtë të refuzojë listën e kandidatëve të propozuar nga Komisioni profesional, duke e arsyetuar atë.
- Rektori zgjidhet me shumicën absolute të votave të anëtarëve të Këshillit Drejtues. Në rast se, asnjë kandidat nuk e fiton këtë shumicë në radhën e parë të votimit, atëherë dy kandidatët me numrin më të madh të votave kualifikohen në votimin e dytë. Nëse, asnjëri nga dy kandidatët nuk e fiton shumicën e votave të anëtarëve të përgjithshëm tri herë radhazi, procedura e zgjedhjes përsëritet nga fillimi, respektivisht, rishpallet konkursi.
- Zgjedhja e rektorit bëhet për një periudhë prej katër vitesh me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat.
- Mandati i rektorit fillon me 1 tetor.
- Për mospranimin e kandidatëve për pozitën e rektorit, për shkak të konfliktit të interesit aplikohen dispozitat e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Kandidatët, së bashku me kërkesën, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Biografinë e shkurtër,
- Çertifikatën e lindjes,
- Vendimin/çertifikatën ekuivalente të titullit akademik,
- Përmbledhjen e përvojës akademike (në mësimdhënie, kërkime shkencore, krijimtari artistike) dhe përvojën menaxheriale,
- Çertifikatën nga gjykata, që nuk është nën hetime.

Dokumentet e kompletuara në kopje fizike duhet të dorëzohen çdo ditë pune, prej orës 8.00-16.00 në zyrën e arkivit të Universitetit "Kadri Zeka" dhe duhet t'i adresohen: Komisionit profesional të Senatit të Universitetit.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediet e shkruara dhe elektronike, përkatësisht nga data 09.06.2023 deri më 23.06.2023, në orën 16.00.

UNIVERZITET "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gnjilane, Kosovo
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. br. 02/1079/ Dt. 08/06/2023

## Konkurs za rektora Javnog Univerziteta „Kadri Zeкa" Gnjilane

Na osnovu člana 19, st. 1, Zakona o visokom obrazovanju Republike Kosova i člana 23, st. 1, tačka 1.9 i člana 27, Statuta Univerziteta, Upravni savet Javnog Univerziteta „Kadri Zeka" u Gnjilanu, na sastanku održanom dana 07.06.2023.godine, doneo odluku o raspisivanju konkursa za:

**Rektora Javnog Univerziteta "Kadri Zeka" u Gnjilanu**

**Kandidati moraju da ispunjavaju sledeće uslove:**

1. Da ima dokazano iskustvo u akademskoj nastavi, naučnoistraživačkom radu i da ima zvanje redovnog profesora, vanrednog profesora ili docenta.

2. Imati dokazano iskustvo u menađmentu-rukovođenju univerziteta.

**Postupak izbora:**

- Konkurs za rektorsku funkciju je otvoren za interne i eksterne kandidate.
- Stručna komisija, koju bira Senat, predlaže Upravnom savetu listu kandidata koji ispunjavaju uslove konkursa za izbor.
- Upravni savet intervjuiše kandidate koji su ispunili uslove za konkurisanje za ovu poziciju. U ovim intervjuima, svaki kandidat prezentira sveobuhvatnu viziju za buduću razvojnu strategiju Univerziteta i sposobnosti upravljanja.
- Rektora bira Upravni savet sa liste kandidata koju predlaže stručna komisija od pet (5) članova. Stručna komisija ima zadatak da proveri da li prijavljeni kandidati za zvanje rektora ispunjavaju uslove utvrđene konkursom.
- Upravni savet ima pravo da odbije listu kandidata koju je predložila Stručna komisija, uz obrazloženje.
- Rektor se bira apsolutnom većinom glasova članova Upravnog saveta. U slučaju da nijedan kandidat ne osvoji ovu većinu u prvom krugu glasanja, tada se dva kandidata sa najvećim brojem glasova kvalifikuju u drugi krug glasanja. Ako nijedan od dva kandidata tri puta uzastopno ne osvoji većinu glasova članova Upravnog saveta, postupak izbora se ponavlja od početka, odnosno konkurs se ponovo raspisuje.
- Rektor se bira na period od četiri godine sa mogućnošću ponovnog izbora na još jedan mandat.
- Rektorski mandat počinje 1. Oktobra.
- Za neprihvatanje kandidata za zvanje rektora, zbog sukoba interesa, primenjuju se odredbe Zakona o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javne funkcije.

Kandidati uz zahtev-prijavu moraju dostaviti sledeću dokumentaciju:

- Kratku biografiju,
- Izvod rođenih,
- Rešenje/ekvivalentno uverenje o akademskom zvanju,
- Sažetak akademskog iskustva (u nastavi, naučnoistraživačkom radu, umetničkom stvaralaštvu) i menađerskog iskustva,
- Potvrdu-Uverenje suda da nije pod istragom.

Popunjena dokumenta u fizičkim kopijama dostavljaju se svakog radnog dana od 8:00 do 16:00 časova u arhivi Univerziteta "Kadri Zeka" i šalju se na adresu: Stručnoj komisiji Senata Univerziteta.

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u štampanim i elektronskim medijama, odnosno od 09.06.2023 godine do 23.06.2023 godine u 16:00 časova.

Në bazë të dispozitave të nenit 21, nenit 25 të ligjit nr. 03/L- 087 për Ndërmarjet Publike, respektivisht neni 13 të ligjit 04/L-111 për ndryshim dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L- 087 për ndërmarjet publike, si dhe ligjit numër 06/L-021 neni 22 për kontrollin e brendshëm të financave publike, Komisioni i Auditimit i Ndërmarjes Publike KRM "Pastrimi" Sh.A. në Prishtinë në mbledhjen e mbajtur me datë 06.06.2023, mori vendim që të shpallë:

## K O N K U R S
## Për kohë te caktuar

**Pozita e punës**: Zyrtar/e Auditimit të Brendshëm - 1 ekzekutues

**Vendi dhe lokacioni i Punës**: Prishtinë,

Zyrtar i Auditimit të Brendshëm /Nën mbikqyrje të Komitetit të Auditimit

**Kohëzgjatja e Kontratës punës** tri (3) vjeçare

***Detyrat dhe Përgjegjësitë:***

- I raportor komisionit të auditimit dhe bordit të drejtorëve për politikat, programet dhe aktivitetet e zyrës.
- Të planifikojë, organizoj dhe mbikqyrë punën e zyrës së Auditimit të Brendshëm, duke përfshirë planifikimin, hartimin dhe menaxhimin e programit për auditim, organizimin dhe delegimin e punëve dhe përllogaritjen e resurseve të nevojshme.
- Përgaditja e planit të punës, zbatimi dhe monitorimi.
- Të monitorojë zbatimin e të gjitha rekomandimeve të Komisionit të Auditimit.
- Të verifikojë përshtatshmërinë dhe fuksionimin e rregullt të kontrolleve të brendshme (duke përfshirë ato financiare), si dhe të raportoj te Komisioni i Auditimit.
- Të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin nga KRM "Pastrimi" Sh.A të të gjitha ligjeve të aplikueshme ne Kosovë.
- Të propozoj masa që duhet të ndërrmeren nga kompania për ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të veprimtarisë.
- Në bazë të planit të auditimit, përgaditë raportet e auditimit për shqyrtim nga Komision i Auditimit.
- Bashkëpunon me zyrtarët e ndërrmarjes në koordinim me Kryeshefin Ekzekutiv.
- Kryen edhe punë dhe detyra tjera te cilat i caktohen nga komisioni i auditimit.
- I përgjigjet: Komitetit të Auditimit të Ndërmarrje

**Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:**

- Diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike, kontabilitet.
  master ne drejtimet ekonomike me theks ekspert në kontabilitet dhe auditimi do te jete përparësi
- Së paku 5 vite përvojë pune menaxhuese në auditimit të brendshëm, lëmin e financave, dhe kontabilitetit;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e auditimeve të deshmohet me kontrata, vendime;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme me theks Ligji per NP dhe I ligjeve qe kane te bejne me kontrollin e brendshem dhe menaxhimin e financave publike;
- Shkathtësi ne komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi kompjuterike ne aplikacione të programeve (word, Excel, Power Point, Access);
- Të jetë i certifikuar në auditim të brendshëm;

### Paraqitja e kërkesave

1. Kërkesat dorëzohen në zyrën nr. 8. të KRM "Pastrimi"sh.a.rr.Tahir Zajmi"nr.5, Prishtinë dhe duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:
2. CV, Përvoja e punës ,Vërtetim nga trusti pensional,Diplomën e fakultetit (e noterizuar),Diploma nga universitetet e huaja duhet te jete e nostrifikuar nga Ministria e Arsimit (deshmi e noterizuar), Çertifikata e Auditimit (e noterizuar),Çertifikata e lindjes jo me e vjetër se gjashtë muaj, Kopja e letërnjoftimit, dëshminë se nuk jeni nën hetime jo me e vjeter se gjashtë muaj (origjinali).
3. Deklarata nën betim.
4. Dokumentet e pakompletuara si dhe ato që arrijnë pas afatitit të konkursit, nuk do të shqyrtohen.
5. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.
6. Konkursi është i hapur 30 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.
7. Informata shtesë mund të sigurohen përmes telefonit nr.038/603-191.

Në bazë të dispozitave të nenit 21, nenit 25 të ligjit nr. 03/L- 087 për Ndërmarjet Publike, respektivisht neni 13 të ligjit 04/L-111 për ndryshim dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L- 087 për ndërmarjet publike, si dhe ligjit numër 06/L-021 neni 22 për kontrollin e brendshëm të financave publike, Komisioni i auditimit i Ndërmarjes Publike KRM "Pastrimi" Sh.A. në Prishtinë në mbledhjen e mbajtur me datë 06.06.2023, mori vendim që të shpallë :

## K O N K U R S
## Për kohë te caktuar

**Pozita e punës:** Auditor/e Brendshëm -1 ekzekutues.

**Vendi dhe lokacioni i Punës**: Prishtinë,

Auditori/e e Brendshëm /Nën mbikqyrje të Komitetit të Auditimit

**Kohëzgjatja e Kontratës punës** tri (3) vjeçare

***Detyrat dhe përgjegjësitë: -***

Nën mbikëqyrjen e zyrtarit të Njësisë së Auditimit të Brendshmëm kryen punët dhe detyrat si në vijim:

- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin merr pjesë në hartimin e planit të auditimit dhe miraton planet e punës dhe afatet për kryerjen e auditimeve dhe shërbimeve përkatëse;
- Kryen auditime, përfsihrë intervista hyrëse me sektorin që auditohet, interviston stafin, merr dhe analizon dokumentacionin përkatës dhe regjistron të gjeturat;
- Përgaditë draft raportin, diskuton me mbikëqyrësin dhe bën intervistën përfundimtare me të audituarin;
- Harton raportin final, me rekomandimet adekuate, finalizon dosjen e auditimit, dhe dorëzon atë për arkivim;
- Monitoron zbatimin e rekomandimeve nga ana e njësive organizative;
- Ofron këshilla dhe udhëzime për çështje të auditimit të brendshëm brenda kompanisë sipas nevojës;
- Koordinon punët me pjesët e tjera të njësive dhe komunikon me autoritetet e jashtme sipas nevojës;
- Të vlerësojë sistemet e kontrollit të brendshëm të dizajnuara nga menaxhmenti se janë adekuate.
- I përgjigjet: Komitetit të Auditimit të Ndërmarrje

**Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:**

- Diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike, kontabilitet apo fusha tjera te studimeve relavante, master ne drejtimet ekonomike me theks në kontabilitet dhe auditimi do te jetë përparësi
- Së paku 5 vite përvojë pune në auditimit të brendshëm.
- Njohuri dhe përvojë në fushën e auditimeve (përvoj pune në auditimin e ndërmarrjeve publike do të jetë përparësi)
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme me theks Ligji per NP dhe ligjive tjera qe kan te bejne me kontrollin e brendshem dhe menaxhimin e financave publike;
- Shkathtësi ne komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit, përparesi kane ata me pervoj menaxheriale në nderrmarrjet publike
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (word, excel, Power Point, Access);
- Të jetë i certifikuar në auditim të brendshëm ne sektorin public, leshuar nga ministria e Fenancave ose Çertifikat per auditor te brendshem ne sektorin public nga ndonje institucion relevant nderkombtar ose vendor

- ***Kualifikimet e preferuara***

Trajnime (EVP) relavante në auditim të brendshëm që deshmojn me çertifikata
Njohuri te programve te ndërrmarjeve publike

**Paraqitja e kërkesave**

1. Kërkesat dorëzohen në zyrën nr. 8. të KRM "Pastrimi"sh.a.rr.Tahir Zajmi"nr.5, Prishtinë dhe duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:
2. CV, Përvoja e punës e deshmuar me kontrata te punes dhe vendime ( të noterizuar) (Vërtetim nga trusti pensional),Diplomën e fakultetit ( e notrizuar), 3.Diploma nga universitetet e huaja duhet te jete e nostrifikuar nga Ministria e Arsimit (deshmi e noterizuar) Çertifikata e Auditimit (e noterizuar),Certifikata e lindjes jo me e vjeter se 6 muaj,
3. Kopja e letërnjoftimit,Gjendjen e pageses nga Trusti , dëshminë se nuk jeni nën hetime çertifikata origjinale jo me e vjeter se 6 muaj
4. Deklarata nën betim.
5. Dokumentet e pakompletuara si dhe ato që arrijnë pas afatitit të konkursit, nuk do të shqyrtohen.
6. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.
7. Konkursi është i hapur 30 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.
8. Informata shtesë mund të sigurohen përmes telefonit nr.038/603-191.

Na osnovu odredbi člana 21, člana 25 Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća, odnosno član 13 Zakona 04/L-111 za izmene i dopune Zakona br. 03/L-087 javnih preduzeća, kao i zakona broj 06/L-021 član 22 o unutrašnjoj kontroli javnih finansija, Komisija za reviziju JP KRM „Pastrimi“ Sh.A. godine u Prištini, na sednici održanoj 28.04.2023.godine, doneo odluku da se, dok nije bilo prijave u najavljenom roku od 30 dana, Komisija za reviziju na sastanku održanom 06.06.2023.godine donela odluku da se ponovo raspiše kandidat:

## KONKURS

Radno mesto: Službenik za unutrašnju reviziju - 1 izvršilac
Mesto i mesto rada: Priština,
Službenik za unutrašnju reviziju / Pod nadzorom Komisije za reviziju
Trajanje ugovora o radu tri (3) godine
Dužnosti i odgovornosti:

- Izveštaji komisiji za reviziju i Upravni odbor za politike, programe i aktivnosti kancelarije
- Planira, organizuje i nadgleda rad Kancelarije za unutrašnju reviziju, uključujući planiranje, izradu i upravljanje programom revizije, organizovanje i delegiranje poslova i proračun potrebnih resursa.
- Izrada plana rada, implementacija i praćenje.
- Praćenje sprovođenja svih preporuka Komisije za reviziju. Revizija.
- Provera podobnosti i pravilnog funkcionisanja sistema i procedura koje imaju za cilj da garantuju implementaciju od strane KRM“ Pastrimi" Sh.A svih važećih zakona na Kosovu.
- Da predloži mere koje kompanija treba da preduzme za povećanje efikasnosti i efektivnosti aktivnosti.
- Na osnovu plana revizije pripremi revizorske izveštaje za razmatranje od strane Komisije za reviziju
- sarađuje sa službenicima kompanije u koordinaciji sa glavnim izvršnim direktorom
- obavlja i druge poslove i zadatke po nalogu komisije revizije.

Kvalifikacija, radno iskustvo i veštine:

- Visoka stručna sprema ekonomije, prava, javne uprave, javnih finansija, računovodstva.Master ekonomskih nauka sa akcentom na računovodstvo i reviziju će biti prednost
- Najmanje 5 godina radnog iskustva u internoj reviziji, u oblasti finansija i računovodstva, liderstvo u internoj reviziji se smatra prednošću;
- Znanje i iskustvo u oblasti revizije mogu se dokazati ugovorima, odlukama; internim i javnim finansijama;
- veštine komunikacije, planiranja rada i vođenja tima
- Poznavanje rada na računaru u softverskim aplikacijama (Vord, Ekcel, Pover Point, Access)
- Posedovanje sertifikata za internu reviziju u javnom sektoru od strane MEF-a ili bilo koje relevantne lokalne ili međunarodne institucije kao što su: SKAK, IKAF, itd.

Podnošenje zahteva

1. Zahtevi se predaju u kancelariju br. 8. KRM „Pastrimi“ š.a.rr.Tahir Zajmi'' br.5, Priština, a potrebno je priložiti i sledeća dokumenta:
2. CV, Radno iskustvo, Uverenje iz penzijskog fonda, Fakultetska diploma (overena), Diploma sa inostranih univerziteta mora biti overena od strane Ministarstva prosvete (dokaz kod notara), Izvod revizije (notarski), Izvod iz matične knjige rođenih ne stariji od šest meseci, Kopija lične karte, dokaz da niste pod istragom ne stariji od šest meseci (original).
3. Izjava pod zakletvom.
4. Nepotpuna dokumenta, kao i ona koja pristignu nakon konkursnog roka, neće se razmatrati. Biće kontaktirani samo kandidati koji uđu u uži izbor.
5. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u dnevnoj štampi
6. Dodatne informacije mogu se dobiti na telefon 038/603-191

Predsednik komisije za reviziju
Valon Gogiqi

Na osnovu odredbi člana 21, člana 25 Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća, odnosno član 13 Zakona 04/L-111 za izmene i dopune Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća, kao i zakon broj 06/L-021 član 22 za unutrašnju kontrolu javnih finansija, Komisija za reviziju JP KRM „Pastrimi“ Sh.A. godine u Prištini na sednici održanoj 28.04.2023.godine doneo odluku o proglašenju, a pošto nije bilo prijave u najavljenom roku od 30 dana, Komisija za reviziju je na sednici održanoj 06.06.2023.godine donela odluku o ponovnom proglašenju takmičara:

## K O N K U R S

### Radno mesto: Interni revizor 1 izvršilac.

Mesto i lokacija rada: Priština,

Interni revizor/ Pod nadzorom Komisije za reviziju

Trajanje ugovora o radu je tri (3) godine

Dužnosti i odgovornosti: - Pod nadzorom službenika Jedinice za unutrašnju reviziju, obavlja sledeće poslove:

U saradnji sa supervizorom učestvuje u izradi plana revizije i odobrava planove rada i rokove za sprovođenje revizija i pratećih usluga;

- Vrši revizije, uključujući uvodne intervjue sa revidiranim sektorom, intervjuiše osoblje, prima i analizira relevantnu dokumentaciju i evidentira nalaze;
- Priprema nacrt izveštaja, razgovara sa supervizorom i obavlja završni intervju sa subjektom revizije;
- Izrađuje završni izveštaj, sa adekvatnim preporukama, finalizuje dosije revizije i dostavlja ga na arhiviranje;
- Prati sprovođenje preporuka po organizacionim jedinicama;
- Pruža savete i smernice o pitanjima interne revizije unutar kompanije po potrebi;
- Koordinira rad sa drugim delovima jedinica i po potrebi komunicira sa spoljnim organima;
- Da proceni sisteme interne kontrole koje je dizajnirao menadžment da su oni adekvatni.

Kvalifikacije, radno iskustvo i veštine:
Prednost će biti fakultetska diploma ekonomije, prava, javne uprave, javnih finansija, računovodstva ili drugih relevantnih oblasti studija, magistar ekonomije sa akcentom na računovodstvo i reviziju.

- Najmanje 3 godine radnog iskustva u oblasti interne revizije, računovodstva i finansija.
- Znanje i iskustvo u oblasti revizije (radno iskustvo u reviziji javnih i privatnih preduzeća će biti prednost)
- Poznavanje važećih zakona i propisa, sa akcentom na Zakon o privatnom kapitalu i druge zakone koji se odnose na internu kontrolu i upravljanje javnim finansijama;
- Veštine u komunikaciji, planiranju rada i vođenju tima, prednost imaju oni sa menadžerskim iskustvom u javnim i privatnim preduzećima.
- Poznavanje rada na računaru u softverskim aplikacijama (vord, ekcel, Pover Point, Access);
- Da bude sertifikovan za internu reviziju u javnom sektoru, izdat od strane Ministarstva finansija ili Sertifikat za internog revizora u javnom i privatnom sektoru od bilo koje relevantne međunarodne ili domaće institucije.
- Budite stručnjak za računovodstvo (Sertifikovani računovođa) iz SKAK-a, IKAF-a ili bilo koje druge domaće ili međunarodne institucije.

Željene kvalifikacije:

- Relevantne obuke (EVP) iz interne revizije, dokazane sertifikatima
- Poznavanje programa javnih preduzeća

Podnošenje zahteva

1. Zahtevi se podnose kancelariji br. 8. KRM "Pastrimi" š.a.rr.Tahir Zajmi'' br.5, Priština i potrebno je priložiti sledeća dokumenta:

2.CV, Radno iskustvo dokazano ugovorima o radu i odlukama (ovjereno) (Uvjerenje iz penzijskog fonda), Diploma fakulteta (ovjerena), Diploma inostranih univerziteta mora biti ovjerena od strane Ministarstva prosvjete (dokaz overen) Uvjerenje o internoj reviziji, Računovođa uverenje (overeno), izvod iz matične knjige rođenih ne stariji od 6 meseci, kopija lične karte, izvod o uplati fonda, dokaz da niste pod istragom, original izvoda ne stariji od 6 meseci

3. Izjava pod zakletvom (primljena u preduzeću).

4. Nepotpuna dokumenta, kao i ona koja pristignu nakon konkursnog roka, neće se razmatrati.

5. Biće kontaktirani samo kandidati koji uđu u uži izbor.

6. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u dnevnoj štampi.

7. Dodatne informacije mogu se dobiti putem telefona 038/603-191.










## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Server Beqiri B.I. N.N.P. Stabiliteti Projekt shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810678162 nrb. 70137407.

- "Auto Geti 1" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së.

- Kosovare Imer Hasanaj shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit të Edukimit në UP "Hasan Prishtina" Prishtinë, Bachelor për shkak të gabimit teknik Kimi –Fizik duhet të jetë Fizik-Kimi me nr. 1243.

- Ilir Sadrijaj nga Gramaçeli, komuna e Deçanit shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11 të sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Petrit Thaçi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" instalues i ujit dhe kanalizimit Gjakovë.

- Petrit Thaçi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Makinerisë Gjakovë.

- Valon Vala nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Joni Bajraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të SH.M.E. "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Joni Bajraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Irfan Gerbani shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën Q K "11 Marsi" Prizren.

- Edin Bicaku shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Visar Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IV shfmu "Bajram Curri" Krushë e Madhe.

- Enver Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIIIshfmu "Fadil Hisari" Prizren.

- CelebicEsef shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- XhelalFerizi shpall te pavlefshme certifikatën QK "11 Marsi" Prizren.

- Valmir Kadrija shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Hivzi Sylejmani" Fushë Kosovë.

- Veton Aliu, shpall te pavlefshme dëftesën e 11 klase te shkollës se mesme ''ARKITEKT SINANI''.

- Bleona Binaku, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme ''FRANG BARDHI''.

- Merlind Qorri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. III të sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Remzi Kida nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 11 të Gjimnazit "Hjadar Dushi" Gjakovë.

- Flamur Godeni nga Gajkova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit" Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Besart Myftari B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb 811937046.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
Partex Sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
RC cola


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues